



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

U-POLIS  
Nr. 65/16. Prot  
M. 24.05.2016

Nr. 5238 Prot.

Tiranë, më 20.05.2016

URDHËR

Nr. 267, datë 20.05.2016

“PËR  
AKREDITIMIN PERIODIK INSTITUCIONAL TË UNIVERSITETIT “POLIS”

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 138 të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 424, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin periodik institucional në përputhje me Vendimin nr. 119, datë 18.02.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë (KA), bashkëlidhur këtij urdhri, të Universitetit “Polis”, i cili ka në përbërjen e tij këto njësi kryesore:
  - a. Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn;
  - b. Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban;
  - c. Instituti për Kërkim dhe Zhvillim (IKZH-POLIS).
2. Universiteti “Polis”, duhet të sigurojë që standardet, mbi bazën e të cilave është dhënë akreditimi, të përmbushen për të gjithë periudhën kohore të vlefshmërisë së akreditimit.
3. Ngarkohet Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, të monitorojë në vazhdimësi ruajtjen e këtyre standardeve.
4. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Universiteti “Polis” .

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

